



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 06 Prot

Vau Dejës, më 18.01.2022

PROJEKT VENDIM
Nr. 05, datë 18.01.2022

Për

Miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies në përdorim për shfrytëzim minerale ndërtimi zhure në objektin Kosmaç, "Subjektit Alba Beton 07" sh.p.k.

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja "el", të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të Pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" pika 3 ;4 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.7.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" ,i propozojmë **Këshillit të Bashkisë Vau Dejës**, ku në mbledhjen e datës _____ . _____ 2022 të **Këshillit të Bashkisë** të:

V E N D O S

1. Rinovimin e kontratës së dhënies me qira për shfrytëzim të Materialeve inerte sipas vendimit të **Këshillit Bashkisë nr.40, datë 21.06.2018** në ekonomine pyjore Drin Gjadër Kirë ,ngastrat **nr. 11,12** djerre/ranishte,si dhe tëngastrës **nr.13** për rrugë kalimi për lidhjen e ngastrave **nr.11;12** në ekonomine pyjore Drin Gjadër Kirë , me gjatësi prej **1.1 km(ose 0.33 ha)**,objekt i shfrytëzimit të mineraleve të **ndërtimit, zhure subjektit Alba Beton 07.Sh.p.k.**
2. Afati i rinovimit të kontratës do të jetë vjetor dhe sipas planeve vjetore të shfrytëzimit të miratuara nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN) dhe të reflektuara në relacionin e sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave,si dhe kontratën e lidhur me mes palëve për vitet në vazhdim.

KRYETARI
MARK BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Nr. 06 Prot.

Vau Dejës, me 18 / 04 2022

RELACION

Për rinovimin e kontratës së dhënien në përdorim me kontratë qeraje të fondit pyjor/kullor për shfrytëzim minerale ndërtimi zhure në objektin Kosmaç ,nga “Subjekti Alba Beton 07”sh.p.k.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia **Vau i Dejës**, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilët është edhe administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ,ka në administrimin e saj gjithsej 31,118.2 ha. Pjesë e këtij administrimi është edhe dhënia me qera/përdorim e këtij fondi pyjor nëpërmjet të tretëve.

“**Subjekti Alba Beton 07**”sh.p.k. për shfrytëzimin e mineraleve të ndërtimi zhure, ka marre lejen e shfrytëzimit nr. 1800 datë 10.05.2016, në zbatim të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar,për sipërfaqen prej **4.1 ha** në ngastrat nr. **11;12**, Ekonomia pyjore Drin Gjadër Kirë. **me nr. pronësie 115;117** sipas VKM nr. 433 dt. 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/Bashkive”,i ndryshuar.

Për tu lidhur me ngastrat **nr. 11,12** me leje minerare dhe objekt shfrytëzimi *Zhure*,subjekti përdor si rruge kalimi **1.1 km** .Kjo fondin pyjor në ekonominë Pyjore Drin Gjadër Kirë, duke kaluar në parcelën pyjore **nr 13**,e cila ka kaluar në Pronësi sipas VKM nr. 433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/Bashkive”. me nr. pronësie **118**.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”,neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika el , është kompetencë e Këshillit të Bashkisë ,tjetërsimi apo dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

1. Me vendim të **Keshillit Bashkise nr.40,date 21.06.2018** është bërë Miratimi i ngastrave/nëngastrave **nr.11.12** në një siperfaqe **djerre** prej **4.1 ha** në ekonominë pyjore Drin Gjadër Kirë për dhënie me qira me objekt shfrytëzimi *Zhure* subjektit **Alba Beton 07.Sh.p.k. si dhe miratimi i** ngastrës **nr.13** në ekonominë Pyjore Drin Gjadër Kirë djerre(Ranishte) për rrugë kalimi për lidhjen e ngastrave **nr.11;12** në ekonomine pyjore Drin Gjadër Kirë , me gjatësi prej **1.1 km(ose 0.33 ha)**,objekt i shfrytëzimit të mineraleve të *ndërtimit zhure*.
2. Afati i miratuar nga Këshilli i Bashkisë i dhënies me qira ka qenë 1(një) vit.
3. Me subjektin **Alba Beton 07.Sh.p.k.** është lidhur kontrata **Nga Bashkia Vau Dejës me Nr.5665.Prot,datë 24.08.2018** me afat një vjeçar,si dhe kontrata **nr.2275.datë. 29.04.2020** me afat një vjeçar.

Nga ana e subjektit dhe AKBN është paraqitur plani vjetor i shfrytëzimit i miratuar nga AKBN me shkresë nr 3159 ,date 25.08.2021 nga data 10.05.2021 deri me 10.05.2022 me hartën përkatëse të shfrytëzimit ,Sipërfaqia sipas ketij plani vjetor të miratuar nga AKBN ,është **1.155 ha**.

a.Tarifat për sipërfaqe në përdorim

Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim,sipas miratimit te AKBN dhe sipas VKM 1064, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391/2006 “ Për tarifat në shërbimin pyjor/kullosor i ndryshuar

6 Për nxjerrje,prodhim dhe depozitim materiale inerte				
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lekë/ha/vit		
		1vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Inproduktive (Ranishte)	540000	495000	440000

Lidhja 2,Pikat 12, tarifohen si më poshte:

b. Tarifat për Përdorim rruge

12. Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues			
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqia e përdorur në km	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lekë/km/vit
1	Ranishte(Djerre)	1.1	30 000

Në total sipas lejes së shfrytëzimit vjetor për vitin 2021-2022 për sipërfaqen **prej 1.155 ha** dhe rrugën e kalimit **1.1 km** ,vlera është **656,700 lekë**, si me poshtë”:

a) Vlerën e përdorimit leke/ha/vit

1.Ranishte/Inproduktive etj 1.155 ha x 540,000 lekë = **623,700 lekë**


a/2)Vlera e përdorimit të rrugës auto në km/vit

Ranishte/Inproduktive etj 1.1 km x 30,000 lekë = **33000 lekë**

Gjithsejt në vlerë prej 656,700 lekë, e cila do të reflektohet në kontratën e lidhur mesë palëve.

Bazuar në sa më sipër propozojmë miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies në përdorim për përdorimin e sipërfaqes së fondit pyjor sipas planeve vjetore të shfrytëzimit të Miratuar nga AKBN,duke u përfshirë brenda sipërfaqes **4.1 ha** sipas lejes së shfrytëzimit nr. 1800 datë 10.05.2016, të lëshuar nga AKBN.

Specialistet

Mark Suli


**Miratoi
Drejtori**

Zeqir Ujka


RROK FTONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE
DREJTORIA MINERARE

Nr. 3159 Prot.

Tiranë, më 25.08 / 2021

Lënda: **MIRATIMI I PROGRAMIT VJETOR TË PUNËS
PËR PERIUDHËN 10.05.2021 deri 10.05.2022**

"ALBA BETON 07" sh.p.k

Z. Gjergj FRROKU

Superstrada Shkodër - Lezhë km14, Zona Kadastrale 3389, nr.pasurie 619, Bushat, Shkodër.

Grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr.8 datë 16.01.2018, të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-s "*Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit të planit vjetor të punës nga zotëruesit e lejeve minerare*", i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 "*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*" dhe të VKM nr. 232, datë 23/03/2011 "*Për Miratimin e Funksioneve të Strukturave Përgjegjëse në Sektorin Minerar të Republikës së Shqipërisë*", pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga ana Juaj, vendosi:

Miratimin e Programit Vjetor të Punës, për Lejen Minerare Nr. 1800 datë 10.05.2016, Objekti: "Kosmaçi", Bashkia Shkodër për shfrytëzimin e mineralit Zhurë, për periudhën 10.05.2021 deri më 10.05.2022.

Ju bëjmë me dije, se zbatimi i programit vjetor të punës për periudhën 10.05.2021 deri më 10.05.2022, nga ana e shoqërisë Tuaj, do të jetë objekt i kontrollit të vazhdueshëm nga strukturat tona të specializuara.

Në zbatim të nenit 18 pika 1/ç, 25/ç dhe 27 pika 2/c të ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 "*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*", subjekti i licencuar ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin për raportimin e aktivitetit të kryer gjatë periudhës 10.05.2021 deri më 10.05.2022, për shqyrtim në AKBN jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi e lejes minerare, pra në datën 10.04.2022.

Në rast të mosrespektimit të këtij afati në zbatim të nenit 45, pika 1, shkronja dh, e ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 "*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*", shoqëria Juaj do të gjobet me një shumë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Mosrespektimi i këtij afati për herë të dytë, dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin e detyrimit ligjor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTORI EKZEKUTIV

ADRIAN BILLYKU





AGJENCIA KOMBETARE E
BURIMEVE NATYRORE
DREJTORIA MINERARE

4653000

4652500

4652000

Konturet e lejes Minerare Nr.1800
Subjekti "Alba-Beton 07" shpk

Siperfaqe prekur nga shfrytezimi
per periudhen 2020-2021

Siperfaqe e planifikuar per periudhen
2021-2022

1800

Rruge auto

Projeksioni i kordinatave
Gauss-Krüger, Pulkovo 1942 zone 4

4380500

4381000